

Nr. 811 Prot.

Datë 11.04.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

SARANDË

Nr.01089 Regj.them

Sarandë më datë 08.04.2024

Nr.444 vendimi

SHPLLJE VENDIMI

DREJTUAR: BASHKISË DELVINE

Për: Për shtetasin Vangjel Çavo- banues në Bajkaj , Delvinë

Pranë kësaj gjykate është gjykuar çështja penale me palë:

KËRKUES: Prokuroria Sarandë

Viktima: Vangjel Çavo

Objekti: "Pushimi i çështjes së procedimit penal nr 670/215"

Me vendimin nr 444 të datës 5.3.2024 , të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë është vendosur:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Pushimin e çështjes së procedimit penal me nr.670 të vitit 2015, për veprën penale "Vjedhja", parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal.
3. Shpenzimet gjatë hetimit paraprak dhe ato gjyqësore, siç janë bërë.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda 15(pesëmbëdhjetë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.

U shpall në Sarandë, sot më 5.3.2024.

Duke qene se ne njoftimin per komunikimin e vendimit qe i eshte nisur nepermjet sherbimit postar, shtetasit Vangjel Çavo – banues në Bajkaj , Bashkia Delvinë , dhe eshte kthyer konfirmimi "Larguar" , bazuar ne nenin 140/5 te K.Pr.Penale nxirret kjo shpallje e cila ze vendin e komunikimit te vendimit. Nje kopje e kesaj shpalljeje afishohet ne kendin e shpalljeve te Gjykares Sarande dhe nje kopje ne **BASHKINE DELVINE.**

K/SEKRETARE

Nexhmie ZENELI

Nr. 812 Prot.

Datë 11.04.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
SARANDË

Nr. regj. them. 21017-00152-23-2024/8
Data e ardhjes 07.02.2024

Nr. Vendimit 23-2024-365
Data e vendimit 27.02.2024

VENDIM

(Për vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm
dhe lëshimin e urdhrit të mbrojtjes)
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, me trup gjykues
të përbërë nga:

Gjyqtar: **Fatmir NDREU**

asistuar nga sekretarja gjyqësore **Suzana Sinani**, sot, më datë 27.02.2024, në Sarandë, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, çështjen civile për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, me nr. **21017-00152-23-2024/8** regj. them., e ardhur dhe regjistruar në datë 07.02.2024, që i përket:

PADITËSE: Bardhule Mustafa, atësia Novruz, amësia Bajame, e datëlindjes 22.01.1963, lindur dhe banuese në Delvinë, lagjja “9 Tetori”.

I PADITUR: Bujar Elmazi, atësia Nexhip, amësia Fetanete, i datëlindjes 09.04.1959, lindur në Vlorë dhe banues në Delvinë.

OBJEKTI: Lëshimin e urdhrit të mbrojtjes.
- Detyrimin e të paditurit të mos kryejë veprime dhune verbale, psikologjike, fizike ndaj paditëses, ish-bashkëshortes Bardhule Mustafa.
- I padituri të mos i afrohet për një periudhë një-vjeçare përtej një distance 200 m. paditëses Bardhule Mustafa.
- I padituri të mos shkojë në banesën ku jeton paditësja.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar.

Gjykata, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, dëgjoi pretendimet përfundimtare të palës paditëse Bardhule Mustafa e cila kërkoi lëshimin e urdhrit të mbrojtjes; të paditurin Bujar Elmazi që e kundërshtoi; pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Procedura

se, nga pala paditëse Bardhule Mustafa, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, është depozituar kërkesëpadia kundër ish-bashkëshortit të saj Bujar Elmazi, me

objekt siç citohet në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Gjykata, pasi e mori në shqyrtim këtë padi, në seancën e datës 09.02.2024, vendosi pranimin e saj për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes për paditësen Bardhule Mustafa. Gjykata caktoi këto masa mbrojtëse: “- Urdhërohet menjëherë i padituri Bujar Elmazi që të mos kryejë dhe të mos kërcënojë se do të kryejë veprë të dhunës në familje ndaj paditëses Bardhule Mustafa; - Urdhërohet menjëherë i padituri Bujar Elmazi që të mos cenojë, ngacmojë apo kontaktojë drejtpërdrejt ose tërthorazi me paditësen Bardhule Mustafa; - I padituri Bujar Elmazi ndalohet të afrohet, të hyjë ose të qëndrojë në banesën ku jeton paditësja në adresën: Delvinë, lagjja “9 Tetori”, si dhe në çdo vend tjetër ku ajo qëndron përkohësisht; - I padituri Bujar Elmazi ndalohet t'i afrohet paditëses në një distancë më të vogël se 200 (dyqind) metër.”

Në përputhje me kërkesat e neneve 19/3 (d) dhe 20, të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar (në vijim ligji 9669/2006), gjykata vendosi që në datë 27.02.2024, të zhvillonte seancën për vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe lëshimin e urdhrit të mbrojtjes. Në këtë seancë u paraqit personalisht, krahas palës paditëse, edhe i padituri Bujar Elmazi.

II.a. Në seancën për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, rezultoi si më poshtë:

Në kërkesëpadinë e paraqitur, paditësja Bardhule Mustafa parashtroi se ka qenë e martuar me të paditurin Bujar Elmazi, por është ndarë me vendim nga Gjykata e Sarandës. Gjatë gjithë bashkëjetesës së saj, ajo shprehet se ka pasur dhunë fizike dhe psikologjike sistematike, por guximin për t'u ndarë nga ai e mori kur u dënua penalisht për veprën penale “ngacmimi seksual” ndaj vajzës së mitur Nertila Elmazi. Ajo parashtroi se i padituri ka kryer burg 16 vjet dhe që kur ka dalë nga burgu, jeton në qytetin e Delvinës dhe e përndjek në mënyrë sistematike kudo që vete, e kërcënon me fjalët “do të shkatërroj”, “do ju vras me tritol të gjithëve brenda në shtëpi”, e fyen nga nëna dhe familja me fjalë të pista. E kërcënon përditë me fjalët “do të vras, do të ngul thikën”.

Ajo parashtroi se jeton në Delvinë, në shtëpinë e saj, me djalin, nusen e djalit dhe një nip të moshës 4 vjeçare. Ajo deklaroi se ka ardhur herë pas here në banesë dhe e ka rrahur me shkop në prani të djalit të saj Fatjon Elmazi. Ka njoftuar Komisarëtin e Policisë Delvinë që ka ardhur e ka shoqëruar për disa orë. Rasti i fundit që e ka kërcënuar me jetë ka qenë më datë 07 shkurt 2024. Ajo shprehet se ai ka vazhduar ta përndjekë dhe t'i thotë se do ta vrasë me tritol.

Paditësja shprehet se ndihet e rrezikuar në jetën e saj nga i padituri.

Pala e paditur nuk ishte e pranishme.

Në këtë gjykim, gjykata, pasi dëgjoi deklaratimet (pohimet) verbale të palës paditëse Bardhule Mustafa, bazuar në përshkrimin e rrethanave dhe fakteve në të cilat pretendohet se janë kryer veprime të dhunës në familje, si dhe motivet e konfliktit, duke u bazuar në bindjen e vet¹, vlerësoi se faktet e pretenduara prej paditëses janë të vërteta. Konkretisht, rezultoi se ish-bashkëshorti i saj Bujar Elmazi ka ushtruar dhunë psikologjike në dëm të saj. Në këto rrethana, gjykata e vlerëson të domosdoshëm lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, në funksion të shmangies së përshkallëzimit të konflikteve në të ardhmen dhe për të siguruar një mbrojtje efektive për paditësen.

Në lidhje me llojin e masave mbrojtëse që duhet të caktohen, gjykata mbajti parasysh rrethanat e çështjes, motivet, natyrën dhe shkallën e dhunës së ushtruar. Prandaj, në funksion të shmangies së përshkallëzimit të konfliktit dhe që të sigurohet mbrojtja efektive e viktimës, është e nevojshme që të merren masat e kërkuara në kërkesëpadi.

II.b. Në seancën gjyqësore për vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe lëshimin e urdhrit të mbrojtjes rezultoi se:

¹ Ky vlerësim i gjykatës bazohet në nenin 15, pika 3 të ligjit 9669/2006, ku sanksionohet se: “kur nuk disponon të gjitha provat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, gjykata lëshon me vendim urdhrin e mbrojtjes, bazuar vetëm në përshkrimin e rrethanave dhe fakteve në të cilat është kryer dhuna në familje, duke u bazuar në bindjen e vet.”

Gjykimi u zhvillua në prani të palëve ndërgjyqëse.

Paditësja Bardhule Mustafa, në seancë gjyqësore, u qëndroi deklaratimeve të veta si dhe përfundimisht kërkoi që të lëshohet urdhri i mbrojtjes.

I padituri Bujar Elmazi kundërshtoi deklaratimet e palës paditëse duke kërkuar moslëshimin e një urdhër mbrojtjeje në favor të saj.

Gjykata administroi vendimin nr. 23-2014-1611 (901), dt. 13.10.2014, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë që ka vendosur zgjidhjen e martesës ndërmjet Bardhule Mustafa dhe Bujar Elmazi, si dhe lënien e fëmijës Maria Elmazi për rritje dhe edukim paditëses. Ky vendim ka marrë formë të prerë më dt. 29.10.2014 pasi nuk u ankimua nga palët.

Gjithashtu, Gjykata administroi vendimin penal nr. 12, dt. 14.02.2006, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, në bazë të të cilit i padituri në këtë gjykim, shtetasi Bujar Elmazi, është gjetur fajtor për kryerjen e veprës penale të *“Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur mbetur në fazën e tentativës”*, parashikuar nga neni 100/2 e 22 i Kodit Penal, duke u dënuar me 16 vjet burgim. Ky vendim, mbi ankimin e të pandehurit, i është nënshtruar gjykimit nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë e cila, me vendimin nr. 40, dt. 28.03.2006, ka disponuar lënien në fuqi të tij. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 738, dt. 23.11.2007, ka vendosur mospranimin e rekursit.

Pala paditëse Bardhule Mustafa, në seancë gjyqësore, u shpreh se ka patur kërcënime, fyerje e ofendime ndaj saj dhe vajzës nga i padituri të cilin e etiketoi si *“një njeri pa mëshirë”*.

I padituri Bujar Elmazi kundërshtoi deklaratimet e palës paditëse, duke u shprehur se ai ishte i sëmurë dhe invalid dhe paditësja e ka nxjerrë nga shtëpia pa shkak.

III. Vlerësimi i gjykatës.

a. E drejta objektive që gjen zbatim në këtë çështje

E drejta për jetë familjare, për të mbrojtur jetën dhe shëndetin fizik dhe psikologjik të njeriut, e drejta e gëzimit të qetë të pronës, për marrëdhëniet me fëmijët dhe për të jetuar në harmoni në një mjedis familjar dhe shoqëror, gëzojnë mbrojtje kushtetuese, si dhe nga instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kështu, në nenin 53 të Kushtetutës sanksionohet se martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit, ndërsa në nenin 8 të KEDNJ-s, parashikohet se: *“Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.”*

Rëndësia e ruajtjes së unitetit të familjes dhe e shmangies së konflikteve brenda saj është e një rëndësie jetike për fatin e shoqërisë njerëzore. Për këtë arsye, çdo ndërhyrje e institucioneve të shtetit për të shmangur dhe parandaluar format e dhunës në familje, duhet të jetë e menjëhershme, por e kujdesshme, në mënyrë që të sigurohet normalizimi i marrëdhënieve dhe jo shtimi i konflikteve.

Në këtë kuadër, Republika e Shqipërisë, me ligjin nr. 104, datë 8.11.2012, ka ratifikuar Konventën e Këshillit të Evropës *“Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”*. Në këtë konventë merret përsipër detyrimi për të ndërmarrë masat e nevojshme legjislative dhe masa të tjera për të parandaluar të gjitha format e dhunës në familje.

Më herët, me ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, *“Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”*, i ndryshuar, legjislatori ka parashikuar mjete dhe mënyra të detajuara për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave që cenohen nga dhuna në familje në të gjitha format e saj.

Ky ligj përmban dispozita të natyrës materiale, të cilat parashikojnë mekanizmat dhe masat e përshtatshme për të parandaluar dhe reduktuar dhunën në familje, si dhe dispozita të natyrës procedurale që rregullojnë procesin gjyqësor në përfundim të të cilit caktohen masat mbrojtëse nga gjykata. **Kështu, në përputhje me qëllimin që ndjek ky ligj (parandalimi dhe reduktimi i dhunës në familje), ka disa përjashtime nga rregullat dhe parimet e përgjithshme të një procesi gjyqësor civil, që kanë të bëjnë me legjitimitetin aktiv dhe pasiv, standardin e të provuarit, afatet e gjykimit dhe rolin më aktiv të gjykatës në zhvillimin e procesit dhe caktimin e masave mbrojtëse.**

Dispozitat e këtij ligji, duhet të interpretohen në përputhje me qëllimet që ai ndjek, frymën e ligjit (orientimi drejt zgjidhjeve pragmatiste dhe të shpejta) dhe natyrën e veçantë të marrëdhënieve (familjare) që ai synon të mbrojë.

Sipas nenit 14, pika 2, të ligjit 9669/2006: *“Kërkesë-padia për urdhër mbrojtjeje mund të paraqitet në çdo kohë para gjykatës nga ana e personave që legjitimohen për ta kërkuar atë. Në rastet kur kërkohet ndihmë e menjëhershme, kërkesa mund të plotësohet dhe të paraqitet pranë komisarariatit më të afërt të policisë dhe punonjësi i policisë vepron në përputhje me ligjin ‘Për Policinë e Shtetit’.*” Sipas nenit 13, legjitimohet të kërkojë lëshimin e urdhrin të mbrojtjes vetë viktimë, përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës, si dhe policia ose prokuroria. Ndërsa, për fëmijët e mitur legjitimohen prindërit ose kujdestari i tij, të afërmit, etj. Gjithashtu, sipas nenit 17, pika (1), paragrafi “b”, me kërkesën e palës, ose gjykata kryesisht, kur çmon se përveç kërkuesit, edhe persona të tjerë, me të cilët kërkuesi ka lidhje familjare ose intime, mund të bëhen shkak për ushtrimin e dhunës, vendos që të përfshihen në urdhrin e mbrojtjes edhe këta të fundit.

Sipas nenit 17: *“Gjykata mund të lëshojë me vendim një urdhër mbrojtjeje vetëm ndaj dhunuesit të përmendur në kërkesë-padi. Ky vendim përmban vetëm masat mbrojtëse që përshkruhen në nenin 10 të këtij ligji. Gjykata lëshon me vendim urdhrin e mbrojtjes duke caktuar një ose më shumë prej masave të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, nëse vërteton se:*

a) ekzistojnë dyshime të arsyeshme për të besuar se dhunuesi përbën rrezik për kryerjen e ndonjë akti të dhunës në familje;

b) lëshimi i urdhrin të mbrojtjes me vendim gjykate është i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin, mirëqenien e viktimës/ave, urdhër në të cilin, përveç kërkuesit, gjykata çmon se mund të përfshihen edhe persona të tjerë, me të cilët kërkuesi ka lidhje familjare ose intime, që mund të bëhen shkak për ushtrimin e dhunës ndaj këtyre të fundit.

Në nenin 3 të këtij ligji jepet përkufizimi i koncepteve/termave, që përmban dispozita e cituar më sipër. Sipas këtij neni, me konceptin dhunë do të kuptojmë: *“çdo veprim apo mosveprim të një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik.”* Pra, çdo sjellje që shkakton cenim të rëndë të të mirave të një rëndësie kushtetuese, të tilla si integriteti fizik, moral apo liria personale e tjetrit, etj.

Me cenim të integritetit fizik do të kuptojmë dëmtimin e shëndetit që përfshin si aspektin fizik, ashtu edhe atë psikologjik (dëmtimin e integritetit psikologjik).

Me cenim të integritetit moral, si një e mirë e mbrojtur nga kushtetuta, do të kuptojmë dëmtimet e nderit dhe dinjitetit personal, apo të reputacionit të mirë shoqëror të njeriut. Të tilla janë sjelljet dëmtuese të së drejtës së “emrit të mirë”, të imazhit, privatësisë, apo fyerjet, tradhtia bashkëshortore, etj. Duhet theksuar se nuk bëhet fjalë për abuzime psikologjike, të cilat klasifikohen si dëmtime të karakterit psikologjik.

Integriteti seksual ka të bëjë me cenimin e paprekshmërisë seksuale dhe të së drejtës për zhvillim normal seksual.

Janë dëmtime të integritetit social ato që sjellin cenimin e marrëdhënieve që viktimë ka me të tretët.

Ndërsa, me cenime të integritetit ekonomik do të kuptojmë mungesën e dhënies së ndihmës morale dhe materiale, si dhe dhuna verbale duke e kërcënuar se do t’i mohojë ndihmën ekonomike. Me fjalë të tjera, mungesën e dhënies së kontributeve nga ana e familjarit, që shkakton një shqetësim të rëndë të familjari tjetër, i cili nuk është ekonomikisht i pavarur. Kjo duhet të ketë një karakter sistematik duke penguar familjarin të kryejë një aktivitet financiar të caktuar, për ta penguar të bëhet ekonomikisht i pavarur.

Për të vendosur nëse sjellja cenuese (veprimi ose mosveprimi) e të mirave të mbrojtura, justifikon lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, duhet vlerësuar nëse dhuna e ushtruar ka sjellë tek viktimë cenim të rëndë të të drejtave të tij/saj. Nuk është e mjaftueshme ekzistenca e një forme dhune, por ajo duhet të jetë e rëndë. Nëse dhuna është ose jo e rëndë vlerësohet rast pas rasti sipas karakteristikave të çështjes konkrete, duke marrë në konsideratë disa faktorë, si personalitetin dhe karakterin e viktimës, moshën, kushtet e veçanta fizike dhe psikologjike në të cilat ndodhet ai, etj.

Nuk kërkohet që të kemi ushtrimin njëkohësisht të të gjitha formave të dhunës, por mjafton kryerja e vetëm njëres prej tyre dhe ekziston rreziku që ajo të përsëritet. Përveç kësaj kërkohet që cenimi të jetë

aktual. Nuk mjafton përshkrimi i disa episodeve të dhunës qoftë edhe të rënda, të ndodhura në të shkuarën, por duhet t'u referohemi ngjarjeve të fundit.

Në lidhje me natyrën e dhunës, duhet mbajtur parasysh se ajo mund të jetë edhe e asistuar, pra, viktimat asistojnë në ushtrimin e dhunës që dhunuesi ushtron ndaj anëtarëve të tjerë të familjes. Kjo formë e dhunës u referohet kryesisht fëmijëve të mitur, të cilët janë më të ndjeshëm dhe i përjetojnë më shumë ngjarje të tilla.

Dhuna konsiderohet e kryer në familje kur ajo është kryer ndaj personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare, siç janë bashkëshorti/ja, **ish-bashkëshorti/ja** apo **gjinia në vijë të drejtë** (fëmijët), etj. (Pika 3/a, ç e nenit 3.) Në kuptim të këtij ligji, "viktimitë" e dhunës në familje është personi ndaj të cilit është ushtruar dhuna, ndërsa dhunues është personi që ka ushtruar dhunën.

Nëse, nga gjykata është lëshuar urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, në rastet që ekziston rreziku që dhunuesi të përsërisë menjëherë dhunën ndaj viktimës, sipas nenit 20 të ligjit 9669/2006: "*Pas përfundimit të seancës gjyqësore për nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, gjykata vazhdon seancën për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes mbi bazën e kërkesës, në zbatim të nenit 16 të këtij ligji. Në përfundim të procesit gjyqësor gjykata: a) vendos anulimin, si dhe ndërprerjen e efekteve të urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar më parë me vendim gjykate, kur ky i fundit nuk arrin të provohet; b) refuzon lëshimin e urdhrin të mbrojtjes me vendim gjykate, kur nuk arrin të provohet urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, i lëshuar më parë me vendim gjykate; c) lëshon urdhrin e mbrojtjes me vendim gjykate në bazë të nenit 17 të këtij ligji. Sipas nevojës, ky vendim mund t'i ndryshojë kushtet e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar më parë me vendim gjykate.*"

Nga interpretimi sistematik i neneve të mësipërme, në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete, arrihet në konkluzionin se, që gjykata të lëshojë urdhrin të mbrojtjes, duhet të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet e mëposhtme:

Së pari, personi që kërkon lëshimin e urdhrin të mbrojtjes duhet të legjitimohet aktivisht për të ngritur padinë. Të tillë janë viktimat e dhunës në familje ose prindërit e fëmijës së mitur, etj., ndaj të cilëve është ushtruar dhunë fizike, psikologjike, seksuale, apo çdo formë tjetër e dhunës që sjell si pasojë cenimin e integritetit moral, social apo ekonomik të viktimës.

Së dyti, kur dhuna ushtrohet nga një pjesëtar i familjes, sipas përcaktimeve të nenit 3 të ligjit nr. 9669/2006, konkretisht vëllezërit, motrat, gjinia në vijë të drejtë, përfshirë prindërit adoptues dhe fëmijët e adoptuar, etj. (Legjitimiteti pasiv.)

Se treti, kur vërtetohet se ekzistojnë dyshime të arsyeshme për të besuar se dhunuesi përbën rrezik për kryerjen e ndonjë akti të dhunës në familje dhe/ose kur lëshimi i urdhrin të mbrojtjes është i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin, mirëqenien e viktimës/ave. **Ekzistenca e dhunës dhe e rrezikut të përsëritjes së saj, duhet vlerësuar objektivisht.** Nuk kërkohet edhe faji në veprimet e dhunuesit në kuptimin që ai të kuptojë dhe dëshirojë në momentin e ushtrimit të dhunës, cenimin e të drejtave të viktimës.

Në lidhje me standardin e të provuarit duhet theksuar se nuk kërkohet që të provohet përtej çdo dyshimi, pra të krijohet bindje e plotë për ekzistencën e dhunës dhe rrezikut të përsëritjes së saj në të ardhmen. Mjafton të krijohet të gjykata një bindje e pjesshme, por e arsyeshme, se ka rrezik që dhuna të përsëritet ose se ekzistojnë nevojat për të caktuar masat mbrojtëse. Për këtë arsye, në nenin 15, pika 3, e ligjit nr. 9669/2006, sanksionohet se: "*kur nuk disponon të gjitha provat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, gjykata lëshon me vendim urdhrin e mbrojtjes, bazuar vetëm në përshkrimin e rrethanave dhe fakteve në të cilat është kryer dhuna në familje, duke u bazuar në bindjen e vet.*"

Së katërti, masat mbrojtëse mund të vendosen vetëm me vendim të gjykatës dhe vetëm ato që përshkruhen në nenin 10 të ligjit nr. 9669/2006, **përveç rasteve që duhet të merren masa mbrojtëse ndaj të miturve.** Konkretisht, sipas pikës 3/1, të nenit 10, të ligjit nr. 9669/2006, "*Gjykata, kryesisht, në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ose/dhe në urdhrin e mbrojtjes, mund të parashikojë masa mbrojtëse për fëmijët që kanë pësuar dhunë ose kanë qenë të pranishëm kur është ushtruar dhunë në familje.*"

Gjykata, sipas vlerësimit të saj, mund të zbatojë edhe masa mbrojtëse e procedura të parashikuara nga legjislati në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, derisa nuk cenohen afatet e procesit gjyqësor të parashikuara nga ky ligj...".

Mund të vendosen një ose disa masa, që çmohen të përshtatshme për të siguruar parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje.

b. Analiza e çështjes

Gjykata, pasi administroi provat, duke mbajtur parasysh kryesisht përshkrimin e rrethanave dhe fakteve në të cilat pretendohet se është kryer dhuna në familje, duke u bazuar në bindjen e vet², vlerëson se faktet e parashtruara janë të vërteta. Konkretisht, rezulton se i padituri Bujar Elmazi e ka dhunuar psikologjikisht paditësen Bardhule Mustafa, siç është analizuar edhe në vendimin për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes.

Gjykata mban në konsideratë, në lidhje me personalitetin e të paditurit, edhe vendimin gjyqësor penal të sipërcituar në bazë të të cilit ai është deklaruar fajtor duke u dënuar me 16 vjet burgim për veprën penale të “*Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur*”, mbetur në tentativë, në dëm të vajzës së tij Nertila Elmazi.

Gjykata vlerëson se i padituri ka shprehur kërcënime, fyerje e ofendime në adresë të paditëses, ndërsa e ka cenuar në mënyrë të vazhdueshme në jetën e saj private në banesën e ndodhur në qytetin e Delvinës. Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse, konstatohet se mes tyre ka një konflikt në lidhje me (bashkë)pronësinë e banesës, por kjo çështje del tej caqeve të këtij gjykimi dhe pretendimet e të paditurit duhet të adresohen rregullisht përmes mjeteve të duhura procedurale në gjykatën kompetente dhe nuk mund të përbëjnë shkas për të paditurin Bujar Elmazi që të ndërhyjë në mënyrë vazhduese në jetën familjare të znj. Bardhule Mustafa, duke i pasjellë kësaj të fundit një atmosferë frike, trazimi shpirtëror dhe ankthi dhe gjendje të vazhdueshme shqetësimi e kërcënimi tek viktimat dhe familjarët e saj.

Për sa më sipër, gjykata vlerëson se është e domosdoshme marrja e masave mbrojtëse në funksion të shmangies së përshkallëzimit të konflikteve në të ardhmen dhe për të siguruar një mbrojtje efektive. Kështu, duhet të konfirmohen masat mbrojtëse të caktuara në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes për paditësen Bardhule Mustafa.

Sikurse ka arsyetuar edhe Gjykata e Lartë (*Shih vendimin nr. 00-2010-997 (335), dt. 13.07.2010, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*), për shkak të natyrës tepër delikate të marrëdhënieve në kuadrin e të cilave manifestohet dhuna në familje, ligjvënësi me ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” ka krijuar mundësinë që, nëpërmjet një procedimi civil, të ofrojë mbrojtje ndaj personave të dhunuar apo të rrezikuar nga kryerja e ndonjë akti dhunë që shfaqet si veprim apo mosveprim, që sjell si pasojë cenimin e integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, apo ekonomik të një personi ndaj një personi tjetër lidhur me marrëdhënie familjare me njeri-tjetrin. Konkretisht, referuar nenit 1, ky ligj ka për qëllim kryesor: “1. Parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore. 2. Garantimin e mbrojtjes me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat të dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar”.

Gjykata e Lartë ka arsyetuar se, në çështje të këtij lloji, **procesi i të provuarit ndryshon nga ai i të provuarit në një procedim penal, jo vetëm për arsye se jemi para një procedimi civil, por edhe për faktin se ligjvënësi, duke synuar një shkallë të lartë të garantimit të mbrojtjes për viktimat, në nenin 15 të ligjit, ka bërë një rregullim të posaçëm në lidhje me procesin e të provuarit të dhunës gjatë shqyrtimit gjyqësor për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes, duke mundësuar jo vetëm një gamë të gjerë provash të cilat mund t'i paraqiten gjykatës, si: dëshmi, raporte të policisë, raport mjekësor, akt-ekspertimi, ekzaminime dhe shpjegime/pohime të palëve, dokumente të tjera të lëshuara nga punonjësit e zyrës së shërbimeve sociale pranë njërive vendore, dokumente të lëshuara nga persona juridike (OJF), por edhe duke i njohur gjykatës që gjykon çështje të këtij lloji diskrecion për të lëshuar me vendim urdhrin e mbrojtjes edhe kur nuk**

² Ky vlerësim i gjykatës bazohet në nenin 15, pika 3 të ligjit 9669/2006, ku sanksionohet se: “kur nuk disponon të gjitha provat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, gjykata lëshon me vendim urdhrin e mbrojtjes, bazuar vetëm në përshkrimin e rrethanave dhe fakteve në të cilat është kryer dhuna në familje, duke u bazuar në bindjen e vet.”.

disponon prova të mjaftueshme bazuar në përshkrimin e rrethanave dhe bindjen e vet. (paragrafi 3 i nenit 15).

Në këtë frymë interpretative të ligjit, çmohet se nga vlerësimi tërësor që gjykata u bën rrethanave të çështjes konkrete, provave të administruara dhe indicjeve, bazuar edhe në bindjen e saj të brendshme, duhet lëshuar urdhri i mbrojtjes në zbatim të nenit 17/1, në kushtet kur ekzistojnë dyshime të arsyeshme për të besuar se dhunuesi përbën rrezik për kryerjen e ndonjë akti të dhunës në familje, si dhe se lëshimi i urdhrit të mbrojtjes është i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin, mirëqenien e viktimës. Gjykata vlerëson se, në pikëpamje të ligjit, domosdoshmëria e lëshimit të urdhrit të mbrojtjes lidhet jo vetëm me garantimin e mbrojtjes, por edhe të parandalimit në të ardhmen të çdo veprimi, apo mosveprimi të kundërligjshëm.

Në këtë rast, ky urdhër mbrojtje duhet të lëshohet për afatin maksimal të lejuar në ligj, sikurse u kërkua përfundimisht nga paditësja në gjykim, konkretisht për 12 muaj, me të drejtë shtyrje, që fillon të llogaritet nga dita e nesërme që ky vendim do të marrë formë të prerë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, bazuar në nenet 126, 306 dhe 310 të K.Pr.Civile dhe ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Pranimin e padisë.
2. Vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe lëshimin e urdhrit të mbrojtjes për paditësen Bardhule Mustafa kundër të paditurit Bujar Elmazi. Caktimin e masave mbrojtëse si vijon:
3. Urdhërohet menjëherë i padituri Bujar Elmazi që të mos kryejë dhe të mos kërcënojë se do të kryejë veprë të dhunës në familje ndaj paditëses Bardhule Mustafa.
4. Urdhërohet menjëherë i padituri Bujar Elmazi që të mos cenojë, ngacmojë apo kontaktojë drejtpërdrejt ose tërthorazi me paditësen Bardhule Mustafa.
5. I padituri Bujar Elmazi ndalohet të afrohet, të hyjë ose të qëndrojë në banesën ku jeton paditësja në adresën: Delvinë, lagjja “9 Tetori”, si dhe në çdo vend tjetër ku ajo qëndron përkohësisht.
6. I padituri Bujar Elmazi ndalohet t’i afrohet paditëses në një distancë më të vogël se 200 (dyqind) metër.
7. Kohëzgjatja e masave të mbrojtjes është për një afat 12 (dymbëdhjetë) muaj, me të drejtë shtyrje, që fillon të llogaritet nga dita e nesërme që ky vendim do të marrë formë të prerë.
8. Shkelja e këtij vendimi përbën veprë penale sipas nenit 321/2 të Kodit Penal.
9. Një kopje e këtij vendimi t’i dërgohet brenda 24 orëve Zyrës së Shërbimeve Sociale të Bashkisë Delvinë, ku ka vendbanimin paditësja, si dhe Komisariatit të Policisë Delvinë.
10. Një kopje e këtij vendimi t’i dërgohet brenda 24 orëve Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë si dhe Zyrës Përmbartimore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.
11. Paditësja të pajiset me dy kopje origjinale të këtij vendimi.
12. Ky vendim është titull ekzekutiv dhe është menjëherë i ekzekutueshëm nga përmbartuesi gjyqësor, komisariatet e policisë dhe njësitë e qeverisjes vendore, të cilët ngarkohen me zbatimin e tij.
13. Shpenzimet gjyqësore janë në ngarkim të të paditurit.
14. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall në Sarandë, sot, më datë 27.02.2024.

SEKRETARE

Suzana Sinani

GJYQTAR

Fatmir NDREU



SHPENZIMET GJYQËSORE

Shpenzime për njoftime

300 lekë, të papaguara

Shënim:

Vendimi ka marrë formë
të prerë në datën 05/03/2024
pasi nuk u ankimua nga palët.

Kryesekretar
Nexhmie ZENELI

